



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Elbasan, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletinin e Prokurimit Publik.**

**AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK**

**TIRANË**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

Nga: Bashkia Elbasan, adresa: Rruga Qemal Stafa, Elbasan

Për: **BOE “PC STORE” sh.p.k. & I.S.S (INTEGRATET SMART SOLUTIONS)” sh.p.k.**

**PC STORE” sh.p.k.** me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare Tiranë

**I.S.S (INTEGRATET SMART SOLUTIONS)” sh.p.k.** me adresë: Rruga e "Kavajës", Kompleksi "Square 21", sh.2, k.9, Tiranë

**Procedura e prokurimit:** Procedurë e Hapur

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kamera sigurie dhe Ndërtim i rrjetit LAN për Godinen e Bashkisë”,** me fond limit prej **13’186’292** (trembëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e dy) **lekë pa tvsh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan.

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-88665-11-22-2023

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. BOE "PC STORE" sh.p.k. me Nipt: L 01606034 A & I.S.S (INTEGRATET SMART SOLUTIONS)" sh.p.k. me Nipt: L 92230027 U**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **12,860,880** (dymbëdhjetëmilion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) **lekë pa tvsh.**

**2. "ALComm Solutions" sh.p.k. me Nipt: M 01427004 J**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **11,921,475** (njëmbëdhjetëmilion e nëntëqind e njëzet e njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) **lekë pa tvsh.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**"ALComm Solutions" sh.p.k. me Nipt: M 01427004 J** për arsyet e mëposhtme:

**Në pikën 2.3.4 tek kriteret e veçanta, kapaciteti teknik autoriteti kontraktor ka kërkuar:**

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fotografi/katalogë/ broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/evpërlistënsipas pikes 2.3.3, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisjet që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit catalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Nr.	Emërtimi i mallrave	Modeli i pajisjes	Emri i prodhuesit	Titujt e katalogeve, nr. faqes së katalogëve për çdo pajisje të ofruar, etj.	Faqja zyrtare e internetit e prodhuesit
-----	---------------------	-------------------	-------------------	--	---

Autoriteti Kontraktor nga verifikimi i dokumentacionit (Katalogu i Pajisjeve) të dorëzuar si pjesë e ofertës nga Operatori Ekonomik ka konstatuar:

**1.** Për pajisjen "Switch 24 porta L2 i menaxhueshëm" nga autoriteti kontraktor tek specifikimet teknike është kërkuar:

1- Switch L2 24 porta I menaxhueshëm

- a- Flash Memory = 128 Mb

Në katalogun “**Skeda teknike**” i paraqitur nga operatori ekonomik për pajisjen "Switch 24 porta L2 i menaxhueshëm" model WI-PMS552F parametrat e mësipërm janë si mëposhtë:

- a- Flash Memory = 64 Mb ( **Website zyrtar** [https://www.wireless-tek.com/product\\_show.php?id=218](https://www.wireless-tek.com/product_show.php?id=218) )

Sa mësipër, specifikimet teknike të pajisjes "Switch 24 porta L2 i menaxhueshëm" model WI-PMS552F në katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik si pjesë e ofertës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**2.** Për pajisjen "Switch 24 porta L3 i menaxhueshëm" nga autoriteti kontraktor tek specifikimet teknike është kërkuar:

2- Switch L3 24 porta i menaxhueshëm

- a- Ram = 2Gb
- b- Flash Memory = 2Gb
- c- Fan 2 Blloqe ushqimi, Hot-swappable

Në katalogun “**Skeda teknike**” i paraqitur nga operatori ekonomik për pajisjen "Switch 24 porta L3 i menaxhueshëm" model WI-PCMS554F-L3 parametrat e mësipërm janë si mëposhtë:

- a- RAM512 Mb ( **Website zyrtar**[https://www.wireless-tek.com/product\\_show.php?id=259](https://www.wireless-tek.com/product_show.php?id=259))
- b- Flash Memory32 Mb( **Website zyrtar**[https://www.wireless-tek.com/product\\_show.php?id=259](https://www.wireless-tek.com/product_show.php?id=259))
- c- Fan 1 Bllokushqimi.( **Website zyrtar**[https://www.wireless-tek.com/product\\_show.php?id=259](https://www.wireless-tek.com/product_show.php?id=259))

Sa mësipër, specifikimet teknike të pajisjes “Switch L3 24 porta i menaxhueshem model WI-PCMS554F-L3 në katalogun e dorëzuar nga operatori ekonomik si pjesë e ofertës nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**Oferta juaj s’kualifikohet për arsyet e mësipërme.**

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të

vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik, **BOE “PC STORE” sh.p.k. & I.S.S (INTEGRATET SMART SOLUTIONS)” sh.p.k.** me adresë: **PC STORE” sh.p.k.** me adresë: Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare Tiranë, **I.S.S (INTEGRATET SMART SOLUTIONS)” sh.p.k.** me adresë: Rruga e "Kavajës", Kompleksi "Square 21", sh.2, k.9, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë prej **12,860,880** (dymbëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.**, është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
OSE PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari  
Aulona Bylykbashi**